



QKSUK

Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës
Univerzitetski Stomatološki Klinički Centar Kosova
University Dentistry Clinical Center of Kosovo



OSK

Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova
Dental Chamber of Kosovo

Nr prot: _____

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRI I SHËNDETTËSISË / MINISTARSTVO ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH	
QENDRA KLINIKE STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS	
UNIVERSITETSKI STOMATOLOŠKI KLINIČKI CENTAR KOSOVA	
UNIVERSITY DENTISTRY CLINICAL CENTER OF KOSOVO	
Njësia Org. Org. jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No
01	935
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum Date
3	16, 11, 2022
Prishtëlnë/a	

Nr prot: 2585/22

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

QENDRËS KLINIKE STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS DHE ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

1. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK) dhe Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK) (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunimin e qëndrueshëm sipas fushave përkatëse, duke e konsideruar të domosdoshëm këtë bashkëpunim për rritjen dhe përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së kujdesit dentar.
2. Koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta, si dhe përfaqësimi i QKSUK-së si njësi zgjedhore në Kuvendin e OSK-së në punën e organeve tjera të OSK-së.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky bashkëpunim do të fokusohet në shkëmbimin e informacioneve reciproke dhe konsulencave të ndryshme në funksion të përmirësimit të cilësisë së ushtrimit të profesionit të stomatologut në QKSUK.

Neni 3

Angazhimet e QKSUK-së dhe OSK-së

Palët do të angazhohen që:

1. Të shkëmbejnë përvoja, njohuri profesionale dhe shkencore mbi bazën e reciprocitetit.
2. Të organizojnë aktivitete të përbashkëta në fushën e EVP, si: ligjërata, kongrese/konferenca, tubime shkencore, seminare, simpoziume, trajnime dhe forma tjera të aktiviteteve me qëllim të ngritjes profesionale të stomatologëve në nivel vendi.
3. Me marrëveshje të ndërsjellët t'i ndajnë detyrat dhe obligimet e përgjithshme në rastet kur organizimi i eventeve të ndryshme është i përbashkët, ndërsa ndarja e shpenzimeve bëhet sipas marrëveshjes paraprake.
4. Të përfshihen në procesin e hartimit të programit vjetor të ligjëratave në kuadër të EVP-së.
5. Të mbështesin organizimin e aktiviteteve për zhvillim profesional të profesionistëve të stomatologjisë përmes sjelljes së ekspertëve dhe profesionistëve në fushën e stomatologjisë.
6. Të bashkëpunojnë në fushën e publikimeve, dhe promovimit të shëndetit oral dhe kujdesit stomatologjik.
7. QKSUK-ja e mbështetë punën e organeve të OSK-së nëpërmjet profesionistëve të vet, pa ndërhyrë në aktivitetet e tyre.
8. Të shqyrtojnë dhe aprovojnë projekte kërkimore të përbashkëta.
9. OSK-ja merr përsipër shqyrtimin dhe akreditimin e planeve vjetore dhe programeve të aktiviteteve të ndryshme të EVP-së të organizuara nga QKSUK-ja.
10. OSK-ja të mbështesë QKSUK-në lidhur me përgjegjësitë disiplinore dhe mbrojtjen e të drejtave të profesionistëve shëndetësorë gjatë ushtrimit të profesionit, në përputhje me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.
11. Të mos lejohet ushtrimi i profesionit të stomatologut në QKSUK pa licencë valide të punës të lëshuar nga OSK-ja, si dhe të ketë paguar anëtarësinë e rregullt vjetore.
12. Të angazhohen në ofrimin e mundësive të specializimeve në qendrat tjera, në degët përkatëse, jashtë Republikës së Kosovës.
13. Të marrin pjesë në botime të përbashkëta në Revistën e Stomatologëve të Kosovës.
14. Të koordinojnë veprimet që kanë të bëjnë me hartimin e dokumenteve strategjike me interes të përbashkët.

Neni 4

Kohëzgjatja e Memorandunit

Ky memorandum lidhet në afat të pacaktuar. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandumi.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.
2. *Palët* bien dakord për format e përmirësimit të mangësive të evidentuara në mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjellët midis tyre.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

PËR QENDRËN KLINIKE STOMATOLOGJIKE
UNIVERSITARE TË KOSOVËS

DREJTORI

Dr. Sc. Kastriot Meqa



PËR ODËN E STOMATOLOGËVE
TË KOSOVËS

KRYETARI

Prof. Dr. Blerim Kamberi



Prishtinë,
16.11.2022